

€399

per person

ROME - VATIKAN Nisje: • 18 Shtator • 9 Tetor

DESTINACIONI

Romë - Vatikan - Tivoli

PERIUDHA

Shtator-Tetor '2026

KOHËZGJATJA

3 Ditë

TRANSPORTI

Me Avion



SHTATOR 2026



Nisje 18 Shtator - Kthim 20 Shtator

- 3 Ditë / 2 Netë
- Çmimi: **399€**
-  Nisja: 06:00 (Tiranë) → 07:40 (Romë)
-  Kthimi: 17:00 (Romë) → 18:35 (Tiranë)



TETOR 2026



Nisje 9 Tetor - Kthim 11 Tetor

- 3 Ditë / 2 Netë
- Çmimi: **399€**
-  Nisja: 06:00 (Tiranë) → 07:40 (Romë)
-  Kthimi: 17:00 (Romë) → 18:35 (Tiranë)

1

ROMA E SHENJTË

DITE

Paraqitja në aeroportin e Tiranës minimumi 2 orë përpara nisjes dhe prezantimi me guidën.

Fluturimi direkt Tiranë – Romë (1 orë : 20 minuta)

Pas mbërritjes në Romë do të fillojmë turin : **Roma e Shenjtë.**

Kjo ditë do ti përkushtohet vizitës në Vatikan. Qyteti i Vatikanit ka qenë rezidenca e Papa-ve që në 1377. Do të fillojmë me Sheshin e Shën Pjetrit, sheshi kryesor përpara Vatikanit përpara të cilit ngrihet me gjithë madhësinë e saj Basilika e Shën Pjetrit, e cila ka filluar të ndërtohet në 1546 sipas një projekti të Mikelanxhelos por që u perfundua në 1589 nga Giacomo della Porta dhe Domenico Fontana. Kupola madhështore e kësaj Basilike projektuar nga Mikelanxhelo dominon sheshin dhe gjithë qytetin e vogël të Vatikanit. Do të bëhet një vizitë e detajuar nga brenda në këtë Basilike në të cilën gjendet një pasuri e vërtetë me vepra arti ku si më të njohurat mund të përmendim “Pieta” e Michelangelos dhe altari madhështor i realizuar në bronz nga Bernini. Kjo guidë do të zgjasë rreth 2 orë duke mos përfshirë hyrjet në muzeumet e Vatikanit.

Pas vizitës në Vatikan do të vazhdojmë me vizitë në Castel S. Angelo, vazhduar me Sheshin Navona ku do të bëhet dhe pushimi i drekës.

Pas dreke vazhdojmë me vizitë në Pantheon, një nga objektet më madhështore jo vetëm të Romës por të gjithë Europës.

Akomodimi në hotel. Fjetia në Romë.

2

ROMA E LASHTË

DITE

Pas mëngjesit do të vazhdojmë turin: **Roma e Lashtë.**

Transferta me autobus nga hoteli tek Parku i Villa Borghese për të vazhduar më pas shëtitjen në këmbë tek Piazza del Popolo, Piazza Spagna, Fontana di Trevi, Via dei Fori Imperiali.

Vizitat e Romës së lashtë vazhdojnë me Teatri i Marcelos, dhe në Sheshin Venezia ku ndodhet dhe monumenti i famshëm Altare dell’Patria, Piazza Campidoloio nga ku mund të shihen dhe Fori Romani.

Ndalesa e radhës do të jetë në simbolin e Romës, në Colosseo (vizitë nga jashtë), dhe me pas në Forumi Romak. Forumi Romak është pikërisht vendi ku ka filluar qytetërimi i vjetër Romak në vitin 753 BC, ku Romuli vrau vëllain e tij Remus dhe themeloi qytetin në Palatino, në Forumin Romak senatorët konspironin kundër njëri tjetrit, në Colosseo luftonin gladiatorët për jetë a vdekje. E gjithë kjo panoramë jete, luftërash, intrigash, pushteti dhe dëshirash qëndron sot pas 2800 vjetësh për të treguar gjallërisht historinë e krijimit të qytetërimit.

Kthim në hotel në pasdite. Fjetia në Romë.

Mengjesi ne hotel.

Pas mëngjesit do të nisemi drejt Tivolit, një qytet i vogël dhe piktoresk afër Romës, është i njohur për historinë e tij të pasur dhe vilat madhështore. I rrethuar nga male dhe me pamje mahnitëse.

Ndër vendet më të famshme është Villa d'Este, e njohur për kopshtet e saj të bukura dhe shatërvanët e mrekullueshëm. (Hyrja me pagesë extra/opsionale)

Pas vizitës në Tivoli transfertat në një ndër qendrat tregtare më të mëdha të Italisë, Roma Village, për shopping.

Pas shopping nisemi për në aeroportin e Romës.

Pas procedurave doganore, nisja nga Roma me fluturimi direkt Romë – Tiranë (1 orë : 30 minuta)

ÇFARË PËRFSHIHET

✓ PËRFSHIHET

- ✓ Udhëtimi vajtje-ardhje me avion Tiranë - Romë - Tiranë. Transfertat dhe Shëtitjet me autobus sipas programit. Akomodimi në hotel 4 Yje për 2 netë në Romë. Mengjeset për të gjitha ditët e udhëtimit. Guida në gjuhën shqipe gjatë Turit. Lejohet të merret me vete në avion vetëm një çantë me përmasa 40cm x 30cm x 20cm deri në 10 kg. (Kujdes - Mbi këto përmasa dhe Bagazh për checkin ka shpenzime ekstra).

× NUK PËRFSHIHET

- × Drekat dhe Darkat gjatë udhëtimit. Biletat e hyrjes në Muze dhe Monumente Turistike. Taksa lokale 7.50 eur personi për natë (e detyrueshme dhe paguhet në zyrë bashkë me pagesën e turit)

VENDTAKIMI I NISJES

- ▶ Nga aeroporti Nënë Tereza, ku duhet të paraqiteni minimumi 2 orë përpara

POLITIKAT E ÇMIMIT PËR FËMIJËT

- ▶ Fëmijët në moshën 2 - 11.99 vjeç përfitojnë 20€ zbritje nga cmimi i paketës

Shenim: Kjo politike hyn ne fuqi vetëm nëse femijët akomodohen në dhomë me 2 të rritur.

DOGANA

- 1) Pashaportë me vlefshmëri minimumi 3 muaj
- 2) Nuk duhet të keni kaluar në 6 muaj e fundit më shumë se 90 ditë qëndrimi në vendet e BE

INFORMACIONE

- ▶ Akomodimi në dhomë teke (single) është me ekstra pagesë në vlerën 50% mbi çmimin për person.
 - ▶ Nëse krevati nuk do të jetë dopio, atëherë do të jenë dy krevatë teke të bashkuar.
 - ▶ Nëse shtrati për personin e tretë/katërt nuk do jetë standart, atëherë do jetë sofa bed (shtrat i shtuar në dhomë).
 - ▶ Operatori Turistik nuk mban përgjegjësi për personat e kthyer nga policia për arsye të ndryshme sic janë mungesë dokumentacioni, ekspuls, skadenca e mjetit identifikues, etj.
 - ▶ Nëse nuk i keni mbushur 18 vjeç dhe udhëton pa praninë e njërit ose asnjërit prej prindërve, ju nevojitet prokurë e noterizuar në gjuhën angleze.
 - ▶ Ekziston mundësia që disa nga përmbajtjet e hotelit/udhëtimit të mos jenë aktualisht në funksion për shkak të rrethanave objektive, të cilat operatori nuk mund të ndikojë.
 - ▶ Cmimet dhe disponueshmëria e muzeumeve, ekskursioneve dhe cdo aktivitet tjetër lokal mund të ndryshojnë dhe janë përgjegjësi e vetë Operatorëve Lokale që mundësojnë këto shitje.
- Për cdo ndryshim në lidhje me këto aktivitete, klienti lajmërohet përpara kryerjes së shërbimit.
- ▶ Kujdesi ndaj sendeve personale gjatë qëndrimit në aeroplan, autobuz, traget, është përgjegjësi individuale e klientit dhe jo e Operatorit

DESTINACIONI	Romë - Vatikan - Tivoli
TRANSPORTI	Me Avion
ÇMIMI	€399.00 / person
ZBRITJE FËMIJË	99% (€5.00)
GJENERUAR	26/06/2026 23:58